

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1446 / prot.

Tiranë, më 02.05.2023

VENDIM

Nr. 31, datë 02.05.2023

PËR

“MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA E SHKOLLIMIT, SIPAS KRITERIT EKONOMIK, SHITESË NË FAZËN I, TË STUDENTIT DRILONA KUQO, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, E CILA STUDION NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1453, datë 02.05.2023 “Mbi miratimin e një studenti që përfiton përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023 sipas kriterit ekonomik, shtesë në fazën e parë”, në mbledhjen e datës 02.05.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e përjashtimit nga tarifa e shkollimit, sipas kriterit ekonomik, shtesë në fazën I, për vitin akademik 2022-2023, për studenten Drilona Kuqo, e cila ndjek studimet në një program studimi të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Efekti financiar total në vlerën 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, përballohet nga Buxheti i Shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.



MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ